



# RÖFIX PI 305 POLITOP

Bojë për muret e brendshme dhe tavanin

**Udhëzime teknike dhe ligjore:**

Gjatë aplikimit të produkteve tona, respektoni të dhënat në skedat teknike, të cilat janë në përputhje me standardet e përgjithshme dhe specifike të vendit, si dhe të merren parasysh rekomandimet e shoqatës kombëtare të specialistëve.

**Fushat e përdorimit:**

Bojë për brenda, mat, me mbulim të mirë, pa emetime (L.F) për mure dhe tavane me bazë disperisoni.

Përdorim në ndërtesa banimi dhe biznesi.


Zgjidhje ideale për aplikime standarde në gamën e kërkesave të mesme dhe të ulët.

Klasa e gërryerjes 3 dhe raporti i kontrastit (aftësia mbuluese) e klasës 2 sipas EN 13300.

E papërshtatshme për zona me ngarkesë mekanike.

**Karakteristikat:**

- Aftësi të mirë mbuluese.
- Çmim i përshtatur me cilësinë
- Pa mjete humbëse.
- Pa aromë
- Rezistent ndaj larjes

**Përpunimi:**

Të dhëna teknike					
SAP-Art. Nr.:	2000152044			2000569344	
NAV-Art. Nr.:	142755	142756	142757	142758	142759
Lloji i paketimit					
Njesi per palete	24 Nj./Pal	24 Nj./Pal	24 Nj./Pal	64 Nj./Pal	64 Nj./Pal
Sasi për njësi	15 l/Nj.	15 l/Nj.	15 l/Nj.	5 l/Nj.	5 l/Nj.
Ngjyra	E bardhë	me ngjyra	I ngjyrosur PK II	E bardhë	me ngjyra
Konsumi	ca. 0,15 l/m <sup>2</sup> /Lyerje				
Dëndësia	ca. 1,5 kg/l				
Vlera e pH	ca. 8				
Përmbajtje VOC	max. 1 g/l				
Kontrasti	Kategoria 2				
Qëndrueshmëria ndaj gërvishjes në gjendje të njomë	Kategoria 3, „i reziston depërtimit të ujit“ (DIN 53778)				
Grada e shkëlqimit	mat				
Këshilla për paketimin	Në kova plastike të riciklueshme				
Temperatura e bazamentit	> 5 - < 25 °C				

SAP-Art. Nr.:	
NAV-Art. Nr.:	142760
Lloji i paketimit	
Njesi per palete	64 Nj./Pal
Sasi për njësi	5 l/Nj.
Ngjyra	I ngjyrosur PK II



# RÖFIX PI 305 POLITOP

Bojë për muret e brendshme dhe tavanin

<b>SAP-Art. Nr.:</b>	
Konsumi	ca. 0,15 l/m <sup>2</sup> /Lyerje
Dëndësia	ca. 1,5 kg/l
Vlera e pH	ca. 8
Përmbajtje VOC	max. 1 g/l
Kontrasti	Kategoria 2
Qëndrueshmëria ndaj gërvishjes në gjendje të njomë	Kategoria 3, „i reziston depërtimit të ujit“ (DIN 53778)
Grada e shkëlqimit	mat
Këshilla për paketimin	Në kova plastike të riciklueshme
Temperatura e bazamentit	> 5 - < 25 °C

**Baza e materialit:**

- Lidhës: Polymer-Dispersion
- Përbërësit: me përbërje fijesh, eliminues i shkumës
- Material mbushës (mineral)

**Kushtet e punimit:** Gajtë përpunimit- dhe tharrjes së materialit, ambjenti përreth ose temperatura e bazamentit nuk duhet të jetë poshtë +5 °C. Koha e tharrjes është e varur nga kushtet e ambjentit rrethues. Nëse kemi një lagështirë ajri prej 65 % dhe një temperaturë ambjenti prej +20 °C, pas afërsisht 5 orësh bazamenti do të jetë tharrë dhe mund të lyhet sipër. Një tharrje të plotë e arrijmë pas afërsisht 3 ditësh.

**Bazamenti:** Bazamenti duhet të jetë i pastër, i qëndrueshëm, i thatë, me aftësi mbajtëse, i lirë nga pluhurat, shpërthimet, elementët ndarës, koret dhe papastërtitë e çdo lloji.  
Prova e sipërfaqes, -klasifikimi dhe -parapërgatitja sipas rregullave nacionale Rregulloret: DIN 18363, Skeda-BFS, ÖAP ose SMGV. Për bazamente të sapo ndërtuara, duhen respektuar koha e tharrjes- koha e lënies nga ana e ndërtuesit të bazamentit, si dhe të dhënat teknike dhe këshillat e tij, në lidhje me këtë produkt.  
Bazamentet duhet të kenë aftësi mbajtëse të lartë. Gjatë prerjes së vijave diagonale, duhet të arrihet vlera 0 dhe 1 sipas EN 2409.

**Bazamenti Trajtimi paraprak:** **Beton:** për bazamente të sheshtëLyerjen e parë dhe të fundit me produktin e përshkruar në këtë skedë.  
Bazamentet duhet të parapërgatiten me RÖFIX PP 301 HYDRO LF. Suvatë e reja RÖFIX të sapo aplikuar, grupet e të cilave janë këtu të shpjeguara mirë, mund të lyhen pas një tharrjeje normale pas 3-4 javësh.  
Koret që mund të jenë krijuar, pluhurat dhe papastërtitë e ndryshme, duhet të pastrohen pa lënë mbetje. Bazamente prej gipsi duhet të lyhen fillimisht me PP 301 HYDRO LF. Më pas 2 shtresa lyerje, dorë e parë dhe e dytë.  
**Shtresa (Alt-) dhe lyerje të forta (Alt-) me bazë dispersioni:** pwr sisteme me shtrat tw meswm (Unistar)  
**Shtresa (Alt-) dhe lyerje të forta (Alt-) me bazë silikati:** pwr ura lidhwse (R57)  
**Bazamente të miksuara, sipërfaqe të vogla të suvatuara - rinuvuara, (psh. përmirësim suvatimi, krisje të shpatulluara, suvatime dhe shpatullime, kanalizime të reja elektrike, etj.):** pwr ura lidhwse (R57)  
**Për letër muri me aftësi mbajtëse:** Lyeni pa e parapërgatitur më parë sipërfaqen me astar ose bojë të sipërme.  
**Për bojra në trajtë ngjitesi dhe letra muri pa ngjites:**

**Bazamenti-Trajtimi paraprak:** Mbulimi përpara aplikimit: sipërfaqe të tjera të ambjentit, si xhama, qeramik, alumin, dritare, sipërfaqe druri, mobilje, dysheme, etj. duhen veshur-mbuluar. Pika të freskëta boje duhen fshirë me një leckë të njomë me ujë.  
Shtresat e bojrave të vjetra të cara dhe të dala ngjyrë duhen larguar mekanikisht.  
Dëmtime të vogla: Përpara lyerjes me astar përmirësoni/riparoni dëmtimet me masën shpatulluese RÖFIX.



## RÖFIX PI 305 POLITOP

Bojë për muret e brendshme dhe tavanin

<b>Përgatitja:</b>	<p>Astarë/Fortësues duhet të hollohen me produktin e duhur duke u përgatitur sipas aftësive thithëse të bazamentit. Nuk duhet të krijohen shtresa të lëmuara/me shkëlqim.</p> <p>Dorën përfundimtare me bojë hollojeni me max 10% ujë.</p> <p>Produkti është i përpunueshëm edhe pas një hollimi të lartë, vlerat e të cilit (fortësia, fuqia mbuluese, bashkimi i kokërrizave, grada e shkëlqimit, grada e bardhësisë, etj.) nuk mund të arrihen më si të parashikuara në skedën teknike.</p>
<b>Përpunimi:</b>	<p>Shtrimi vijon i plotë, i njëtrajtshëm, duke mbuluar gjithshka, me anë të një furce, apo rruli.</p> <p>Rrul 2 herë</p> <p>Aplikimi me makinë kryhet i njëtrajtshëm me anë të një pajisje sprucuese të përshtatshme</p> <p>Nëse do të lyeni me pompë, boja duhet të përzihet dhe të sitet mirë përpara se të aplikohet.</p>
<b>Këshilla:</b>	<p>Për veshjen e bazamenteve duhet të respektohen rregullat nacionale si dhe ato europiane. Mbi të gjitha rregullat e përpunimit dhe ato rakorduese të standateve internacionale si psh. ÖAP, SMGV ose Skedat - BFS, etj. Në rast të ndonjë konflikti, jeni të lutur të na kontaktoni.</p>
<b>Këshilla në rast reziku:</b>	<p>Informacione më të detajuara për sigurinë mund ti lexoni tek skedat tona të sigurisë. Përpara aplikimit të produkteve, jeni të lutur ti lexoni me kujdes këto skeda.</p>
<b>Këshilla për përpunimin:</b>	<p>Një sipërfaqe e njëtrajtshme duhet të aplikohet në një dorë „e freskët mbi të freskët“ ose më saktë „e njomë mbi të njomë“ për të shmangur disnivelet.</p>
<b>Magazinimi:</b>	<p>Magazinojini në vende të freskëta, të mbrojtur nga ngrica dhe të mbyllura mirë.</p> <p>Magazinimi min. 24 muaj.</p>
<b>Deklaratë:</b>	
<b>Këshilla të përgjithshme:</b>	<p>Kjo skedë teknike anulon dhe zëvendëson të gjitha versionet e mëparshme.</p> <p>Skedat tona teknike më të reja, me të dhënat aktuale, mund ti gjeni edhe në faqen tonë të internetit (<a href="http://www.roefix.com">www.roefix.com</a>), ose mund të kërkohen edhe pranë filjaleve rajonale në vënd.</p> <p>Informacione më të detajuara për sigurinë mund ti lexoni tek skedat tona të sigurisë. Përpara aplikimit të produkteve, jeni të lutur ti lexoni me kujdes këto skeda.</p> <p>Produktet RÖFIX si dhe të gjitha materialet përbërëse, i nënshtrohen një kontrolli të vazhdueshëm, me anë të të cilit garantohet një cilësi e pandryshueshme.</p> <p>Vlerat teknike janë bazuar tek produktet bazë. Gjatë pigmentimit ose ngjyrosjes, janë të mundshme edhe devijime nga të dhënat teknike. Në dhënien e vlerave bëhet fjalë për vlera mesatare. Meqënëse produktet tona përbëhen nga materiale natyrore, mund të ndodhë që në një ngarkesë të kemi edhe devijime minimale të vlerave. Për veshjen e sipërfaqeve, të cilat këtu nuk janë përshkruar, do të ishte i nevojshëm një marrje mendimi nga ana jonë. Në rast porosie plotësuese ose në lidhje me katalogun e ngjyrave, pigmentet mund të ndryshojnë minimalisht, prandaj dhe në kantieri duhet të bëni si fillim një mostër për krahasim. Të dhënat në lidhje me kohën e pritjes-veprimit janë percaktuar në kushtet e laboratorit (+20 °C/65 % Lageshtirë/e mbetur) dhe sipas kushteve të kantierit mund të ndryshojnë.</p> <p>Të dhënat janë pa rrezik për vërtetësinë dhe plotësinë dhe pa detyrime për kërkesa të çdo natyre, si dhe të rezolutave të klientit. Janë të vlefshme edhe Skedat Teknike të produkteve RÖFIX, të cilat janë të përmëndura edhe në këtë skedë teknike.</p> <p>Shërbimi ynë i konsulencës teknike është në dispozicionin tuaj në rast pyetjesh lidhur me përdorimin, përpunimin si dhe demonstrimin e produkteve tona.</p> <p>Stafi ynë është i gatshëm tju japë cdo ndihmë teknike në lidhje me përdorimin, përpunimin si dhe mund të ofrojë edhe trajnime praktike në lidhje me përdorimin e produkteve tona.</p>